



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Për:	Gazmend Muhaxheri- Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj- Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës
Kopje:	Erblin Hetemi- U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa- Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj – Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Përmes:	Samire Ademi Zefaj, U.d. Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Lulzim Kadriu, U.d. Drejtor i Departamentit Ligjor
Lënda :	Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Pejës
Lloji i aktit:	Vendim
Date:	16.06.2025

I/e nderuar Kryetar,

I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për Ndryshim-Plotësimin e

Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MINT me datë: 04.06.2025 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë, Vendimin Nr. 36/2025 Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2026-2030 e miratuar me datë 29.05.2025 në Komunën e Pejës, andaj si Ministri:

KONFIRMON

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Vendimit Nr. 36/2025 dhe Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit 2026-2030 e miratuar me datë 29.05.2025 në Komunën e Pejës, vlerëson se Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2026-2030 nuk është në kundërshtim me Strategjinë e Turizmit të Kosovës 2024-2030 dhe me legjislacionin në fuqi tashmë të miratuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

ARSYETIM

Bazuar në legjislacionin në fuqi tashmë të miratuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, departamenti ligjor pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës për shqyrtimin e ligjshmërisë të Vendimit Nr. 36/2025 Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2026-2030 në Komunën e Pejës, në bashkëpunim me departamentin e turizmit i cili ka një rol kyç për zhvillimin, promovimin dhe menaxhimin e turizmit në Kosovë, konstaton se Vendimi i lartë cekur nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e as me Strategjinë e Turizmit të Kosovës 2024-2030 tashmë të miratuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë.

Me respekt,